

OPINION I PALES SË INTERESIT MBI VENDIMIN NR. 247, DATË 13.12.2021 MBI FILLIMIN E PROÇEDURËS PËR DISA SHTESA NË RREGULLOREN "PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES", MIRATUAR ME VENDIMIN NR.166, DATË 10.10.2016, TË BORDIT TË ERE-S, E NDRYSHUAR

Në lidhje me konsultimin publik të kërkesës së ISHTI nr 5393 dt 30/08/2021, pika 1 dhe pika 2. e kërkesës, lutemi gjeni disa mendime sa më poshtë:

Qeveria Shqiptare ka nisur një fushatë të gjerë të lehtësimit të proçedurave të shërbimeve publike, duke lehtësuar si komunikimin qytetar/biznes por edhe atë ndërinstitucional, duke vënë në dispozicion platformën e shërbimeve të AKSHI_t e-albania. Fryma e bashkëpunimit institucional është që gjatë ofrimit të një shërbimi publik çdo dokument i qytetarit/biznesit në zotërim të një agjensie shtetërore i vihet në dispozicion çdo agjensie tjetër e cila ka nevojën ligjore për këtë dokument. Në këtë frymë, vlerësoj që nevoja e ISHTI për rregjistrim pranë saj të projektit elektrik para vënies në tension, pika 1 e kërkesës, është një hallkë e shtuar në dëm të kostove të biznesit dhe qytetarëve. Kjo për arsyen që projekti elektrik i nevojshëm për të marrë leje ndërtimi por dhe ai i kolaudimit të sistemit elektrik depozitohet në regjistrin e lejeve të ndërtimit bazuar në legjislacionin përkatës që rregullon aktivitetin e regjistrimit të lejeve të ndërtimit që mirëmbahet nga Agjensia e Zhvillimit të Territorit (https://ealbania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6093 dhe <http://azht.gov.al/legjislacioni/>)

Si rrjedhojë, për sa i takon rregullores së lidhjeve të reja dhe nevojës për depozitim projektsh elektrike të dy institucionet, ISHTI dhe OSSH duhet të reduktojnë burokracinë në lidhje me qytetarin dhe biznesin, duke kërkuar për të aksesuar vetë keto insitucione në regjistrin e lejeve të ndërtimit, për të marrë në disponim projektet fillestare dhe ato të zbatimit, dhe eliminuar në këtë mënyrë kontakte shtesë me biznesin dhe qytetarin.

Në të njëjtën frymë, sa ketu më lart, dhe nevoja për depozitim projektsh për lidhjet 0_20 kw (pika 2 e kërkesës) dhe projektet e rikonstrukcionit (modifikimit/shtesat) e lidhjeve elektrike janë objekt i lejeve të ndërtimit dhe si pasojë duhet të ushtrohet i njëjti parim.

Më tej vërejmë që heqja e disa hallkave dhe burokracive që lidhen me depozitim projektsh pranë ISHTI në vitin 2016 bëri të mundur që Shqipëria të fitojë rreth 30 vënde renditje në indeksin e të bërit biznes dhe lehtësimit të aksesit në rrjetin e energjisë elektrike (Doing Biznes publikim vjetor i Bankës Botërore).

Rifutja tashmë në formë tjetër e një kërkesë të propozuar nga ISHTI është një hap mbrapa në këto përpjekje dhe si e tille duhet të refuzohet në mënyrën që është kërkuar për të 2 pikat e saj.

Bazuar në opinionin tim, alternativa e rekomandueshme për një ndryshim cilësor në rregulloren e lidhjes në rrjetin e shpërndarjes dhe arritjes së përputhmërisë me legjislacion për ISHTI dhe OSSH, duke evituar hallkat shtesë për sa i takon depozitimit të projektit elektrik është ndërveprimi institucional AZHT, OSSH dhe ISHTI në komunikimin elektronik (kundrejt aksesve në sistemin e leje apo sistem tjetër komunikimi elektronik të AZHT apo AKSHI) për vënien në dispozicion ndaj OSSH dhe ISHTI të

a. kërkesës për leje ndërtimi dhe specifikisht zërit depozitim projekti elektrik

b. kërkesës për kolaudimin zëri projekti i zbatimit, si për leje ndërtimi për herë të parë por dhe rikonstrukcion të ndërtimeve aktuale të të gjitha llojeve të cilat çojnë në ndryshime të projekteve elektrike dhe lidhjes në rrjet.

OPINION I PALES SË INTERESIT MBI VENDIMIN NR. 247, DATË 13.12.2021 MBI FILLIMIN E PROÇEDURËS PËR DISA SHTESA NË RREGULLOREN "PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES", MIRATUAR ME VENDIMIN NR.166, DATË 10.10.2016, TË BORDIT TË ERE-S, E NDRYSHUAR

Kjo do të bënte te mundur

- 1- Reduktimin e një hap tjetër, atë të depozitimit të projekteve origjinale pranë OSSH;
- 2- Aplikimi tërësor elektronik të kërkesës pranë OSSH për lidhje të reja apo modifikim në sistemin e shpërndarjes;
- 3- Pajise ISHTI me të dhëna elektronike (regjister) projektsh sipas nevojës ligjore pa asnje kontakt apo kosto shtese me qytetarin dhe biznesin.